

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10171, DATË 22.10.2009, "PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi në Ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i profesionit të Agronomit, si profesion i rregulluar.

Objektivi që synohet të arrihet është përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, për profesionin e Agronomit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe veçanërisht me konsolidimin dhe sigurinë juridike në fushën e sigurisë ushqimore për nënfushën e mbrojtjes së bimëve si dhe për rritjen e nivelit të shërbimeve të ekstensionit bujqësor.

Ky projektligj nuk është parashikuar në vendimin nr. 37, datë 24.1.2018 "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018", por miratimi i tij është shumë i rëndësishëm.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji duke përcaktuar në profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë edhe profesionin e agronomit, do të rrisë besueshmërinë dhe përgjeshmërinë e këtij profesioni, do ti japë një vlerë të shtuar duke rritur në mënyrë të drejtëpërdrejtë rolin dhe ndikimin e këtij profesioni në bujqësi. Shërbimi

i mbrojtjes së bimëve, edhe pse është i ngritur me ligj dhe ka detyra të mirëpërcaktuara, që nga viti 2010 nuk ekziston, mungesa e këtij shërbimi ka vendosur vendin tonë në një pozicion jo të favorshëm në lidhje me besueshmërinë e ofruar për masat fitosanitare të marra për produktet me origjinë bimore që Shqipëria eksporton. Këta profesionistë duhet të çertifikojnë të gjitha produktet e kësaj kategorie që eksportohen dhe që kanë trend rritës nga viti në vit. Aktualisht ky çertifikim është fiktiv, sepse agronomët kanë ikur në drejtim të paditur.

Roli i agronomit do të ndihmojë në menaxhimin më të mirë dhe më të shpejtë të risqeve ushqimore me origjinë bimore, si pasojë e rritjes së efikasitetit të punës së shërbimit të mbrojtjes së bimëve, përmirësimit të kontrollit dhe zbatimit të masave fitosanitare për parandalimin, monitorimin, diagnostikimin, trajtimin dhe çrrënjosjen e parazitëve të bimëve.

Roli i agronomit nuk është i dukshëm në të gjitha problematikat në bujqësi, duke filluar nga përkujdesja e tokës deri në prodhimet në fermë edhe pse është i pazëvendësueshëm. Vlerësimi profesional, dinjiteti dhe personaliteti i munguar në vite bëhen realitet vetëm nëpërmjet këtij ligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk për afrosh legjislacionin e BE-së, por propozon që të shtohet në ligjin ekzistues edhe profesioni i agronomit, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj ka dy nene. Në nenin 1 të tij, propozohet një shtesë në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe konkretisht pas shkronjës "h", të pikës 1, të nenit 5, shtohet shkronjat "i", për profesionin e Agronomit.

Në nenin 2 përcaktohet hyrja në fuqi e këtij projektligji.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Bujqësisë edhe Zhvillimit Rural.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Niko Peleshi

Konceptoi: I. Biçi
Miratoi: L. Çuko
Miratoi: Sh. Zyla
Konfirmoi: A. Alimadhi